



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2017

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Gjeografi e thelluar

Udhëzime të përgjithshme

- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundshme të përgjigjeve të nxënësve.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

• **Pyetjet me zgjedhje**

Numri i pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	B	A	C	B	B	A	D	A	C	B

• **Pyetjet me zhvillim**

Pyetja 11 **3 pikë**

- a) Projektioni cilindrik ose merkator.
b) Në bazë të hartës Groenlanda ka sipërfaqe më të madhe se Australia, ndërkohë që në realitet është krejt e kundërta.

Sepse ky lloj projektioni i përdorur shformon sipërfaqet e Tokës pranë poleve (në gjerësi të mëdha gjeografike).

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse përcakton saktë llojin e projektionit hartografik dhe bën shpjegimin e plotë.

OSE

2 pikë Nëse përcakton saktë llojin e projektionit hartografik dhe bën shpjegim të pjesshëm.

1 pikë Nëse përcakton përcakton saktë llojin e projektionit hartografik OSE bën shpjegim të pjesshëm.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 **3 pikë**

- Problemi i uljes së fuqisë punëtore.
- Problemi i shtimit të ambienteve të kujdesit për të moshuarit.
- Problemi i shtimit të madh të numrit të pagesave të pensionistëve.
- Problemi i uljes së numrit të shkollave, duke qenë se ulet ndjeshëm përqindja e grupmoshës 0-14 vjeç etj.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse përcakton tre nga problemet.
2 pikë Nëse përcakton dy nga problemet.
1 pikë Nëse përcakton një nga problemet.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 **4 pikë****a) Karakteristikat:**

- Janë lëvizje të ngadalta shekullore.
- Kapin territore të mëdha.
- Vihen re më shumë pranë brigjeve detare.

b) Dëshmitë

- Formimi i ishujve koralorë.
- Thellimi i shpejtë i shtretërve të lumenjve.
- Krijimi i tarracave lumore dhe detare.
- Tarracat detare mund të arrijnë deri në 1 000m lartësi etj.
- Deltat e mbytura.
- Zgjatja e luginave lumore në thellësitë detare.
- Vendbanimet e mbytura etj.

Nxënësi fiton:

- 4 pikë** Nëse jep një nga karakteristikat e lëvizjeve luhatëse dhe tre nga dëshmitë.
3 pikë Nëse jep një nga karakteristikat e lëvizjeve luhatëse dhe dy nga dëshmitë.
OSE
2 pikë Nëse jep një nga karakteristikat e lëvizjeve luhatëse dhe një nga dëshmi **OSE** dy nga dëshmitë.
1 pikë Nëse jep një nga karakteristikat e lëvizjeve luhatëse **OSE** një nga dëshmitë.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14 **3 pikë****Kriteri:**

Një kriter i rëndësishëm për klasifikimin e rajoneve është ndërthurja e elementeve fizikë dhe atyre humane.

Shembujt:

P.sh. Antarktida është kontinent për nga madhësia, por nuk përfaqëson një rajon funksional, pasi nuk kemi praninë e elementëve humane, ndërkohë që Amerika e Jugut p.sh. është një rajon gjeografik funksional, sepse ka të mishëruar tërësinë e faktorëve fizikë dhe humanë.

Shënim: Si rajon funksional apo jofunksional, nxënësi mund të japë edhe shembuj të tjerë.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse përcakton saktë kriterin e dallimit të dy tipave të rajoneve dhe jep dy shembuj specifikë për secilin.
OSE
2 pikë Nëse përcakton saktë kriterin e dallimit të dy tipave të rajoneve dhe jep një shembull specifikë për secilin.
1 pikë Nëse përcakton saktë kriterin e dallimit të dy tipave të rajoneve **OSE** jep një shembull specifikë për njërin nga rajonet.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15**3 pikë**

Evropa ka qenë furnizuesi kryesor me popullsi, sidomos në kohën e kolonializmit dhe zbulimeve të mëdha gjeografike, ashtu edhe pritës me emigrantë të ndryshëm nga vendet në zhvillim e të pazhvilluara. Veçanërisht pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, Evropa do të kthehej në kontinentin kryesor pritës pas Amerikës së Veriut, të popullsisë së shpërngulur nga vende të ndryshëm të botës.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan periudhën e kolonializimit dhe zbulimeve gjeografike lidhur me emigrimin drejt Amerikës, si edhe faktin që Evropa ka qenë kontinenti kryesor pritës për popullsinë e shpërngulur nga vende të ndryshme të botës .

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy nga të mësipërmet.

1 pikë Nëse shkruan një nga të mësipërmet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16**3 pikë**

a) Në figurën 1 baticat e formuara janë më të mëdha, pasi forcës tërheqëse të Hënës i shtohet dhe forca tërheqëse e Diellit.

Në figurën 2, Toka, Hëna dhe Dielli janë në kënd të drejtë. Në këtë mënyrë, baticat e formuara janë më të vogla, pasi baticat e formuara nga Hëna zvogëlohen nga baticat e formuara nga Dielli.

b) Disavantazhi do të ishte se stacioni **nuk** do të punonte 24 orë pa ndërprerje, pasi do të varej nga baticat.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse bën saktë dallimin në formimin e baticave midis dy figurave dhe jep një disavantazh.

OSE

2 pikë Nëse bën saktë dallimin në formimin e baticave midis dy figurave **OSE** bën shpjegim të pjesshëm të kërkesës **a** dhe jep një disavantazh.

1 pikë Nëse bën shpjegim të pjesshëm të kërkesës **a** **OSE** jep një disavantazh.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17**3 pikë**

a) Faktorët natyrorë (pozicioni gjeografik, klima) përcaktojnë llojet dhe nivelin e ndryshëm të aktiviteteve ekonomike.

b) Teknologjia e përdorur (e përparuar ose jo) e cila përcakton llojin dhe intensitetin e aktiviteteve ekonomike

c) Faktorët shoqërorë: organizimi politik i territorit është faktor i rëndësishëm në përcaktimin e nivelit dhe zhvillimit të degëve të ndryshme të ekonomisë. Shfrytëzimi kolonial dhe neokolonial i shumë vendeve ose izolimi i gjatë i shumë vendeve të tjera.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tri nga faktorët;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy nga faktorët;

1 pikë Nëse shkruan një nga faktorët;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18 **2 pikë**

Shtimin më të lartë natyror e ka shteti E sepse diferenca midis lindjeve dhe vdekjeve del 20.4‰

Nxënësi fiton:

2 pikë Nëse gjen shtetin E dhe shpjegon që shtimi natyror gjendet nga diferenca e numrit të lindjeve me numrin e vdekjeve.

OSE

1 pikë Nëse gjen shtetin E.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19 **3 pikë**

Sipas Maltusit,

- Rritja e pakontrolluar e popullsisë bëhet në progresion gjeometrik, ndërsa pasuria në progresion aritmetik.
- Pra rritja e pasurisë botërore nuk i përgjigjet rritjes së popullsisë, sidomos në vendet e pazhvilluara dhe për këtë arsye ka varfëri, uri e trazira, të cilat do të vazhdojnë nëse nuk kontrollohet rritja e popullsisë botërore.

Sipas nemaltusianëve,

- Ekzistojnë disa marrëdhënie të rregulluara popullsi-burime natyrore e humane dhe për këtë rritja e popullsisë të jetë në raport të drejtë me prodhimin dhe konsumin e të mirave materiale, pra me mirëqënien.

Nëse do krahasonim të dyja teoritë, teoria neomaltusiane del më e drejtë, pasi në rast se do të zvogëlohej ndjeshëm numri i lindjeve sipas Maltusit, dalin probleme të tjera me plakjen e popullsisë.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse bën krahasimin dhe jep një argument.

OSE

2 pikë Nëse bën vetëm krahasimin e plotë OSE krahasimin e pjesshëm dhe jep një argument

1 pikë Nëse bën krahasimin e pjesshëm.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 **3 pikë**

- a) Rajoni Jugor ka një relievmë të rregullt sesa Rajoni Juglindor (Rajoni Jugor përbëhet nga ndërthurja e rregullt e maleve dhe luginave lumore, ndërsa Rajoni Juglindor ka një relievmë të çrregullt, pasi ndërthuren malet me gropat, fushëgropat, pragjet, malësi lugina etj.
- b) Rajoni Juglindor përbëhet nga struktura shkëputëse të tipit horst graben, ndërsa Rajoni Jugor nga struktura rrudhosëse
- c) Rajoni Jugor përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë e terrigjenë, ndërsa rajoni Juglindor nga terrigjenë, gëlqerorë, flish, magmatikë.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse përcakton ndryshimet midis rajoneve në të tria drejtimet.

OSE

2 pikë Nëse përcakton ndryshimet midis rajoneve në dy nga drejtimet.

1 pikë Nëse përcakton ndryshimet midis rajoneve në një nga drejtimet.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.
